

Kthim pergjigje nr. 205 Mon 2/1/2021 1:42 PM

Përshendetje Z. Brakaj!

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar elektronikisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr. 205 në regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

- Numri i çështjeve gjyqësore administrative për heqje nga puna të punonjësve të administratës me objekt të paditur DPT, për periudhën 2014-31 deri Dhjetor 2020, është 313.
- Numri i çështjeve gjyqësore administrative për heqje nga puna të punonjësve të administratës me objekt të paditur DPT për periudhën 2014-31 deri Dhjetor 2020, që me vendim gjykate i është dashur të paguajë dëmshpërblim financiar kundrejt palës paditëse është 197.

Në lidhje me dy pyetjet e tjera të kërkesës tuaj, përsa i takon vlerës totale të dëshpërblimeve dhe vlerës totale të detyrime të prapambetura, i jemi drejtuar Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale për një qëndrim dhe vlerësim të kësaj kërkesë dhe jemi në pritje të një përgjigje nga ana e tyre. Sapo të kemi një vlerësim të kërkesës do ju bëjmë me dije për përgjigjen në lidhje me këto dy pyetje.

Faleminderit për mirëkuptimin.

Në vijim të dy pyetjeve 3 dhe 4 të kërkesës tuaj, përsa i takon vlerës totale të dëshpërblimeve dhe vlerës totale të detyrime të prapambetura, Ligji Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” në nenin 7 “Kategoritë që bëhen publike pa kërkesë” ka përcaktuar se:

Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit.....

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifatat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara.

Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dalë me Udhëzimin Nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, i cili në kreun II të tij ka përcaktuar se të dhënat e kërkuara në rastin konkret bëhen publike pranë faqes zyrtare të MFE.

Referuar ligjit të sipërcituar Nr.119/2014 neni 7 “Kategoritë që bëhen publike pa kërkesë” të dhënat e kërkuara nga ju, mund të aksesohen pa kërkesë pranë faqes zyrtare të MFE.

Faleminderit për mirëkuptimin.

Kthim pergjigje Nr. 205 Thu 2/18/2021 3:56 PM

To: marjo.braka1@gmail.com;

Përshëndetje Z. Brakaj!

Në vijim të dy pyetjeve 3 dhe 4 të kërkesës tuaj, përsa i takon vlerës totale të dëshpërblimeve dhe vlerës totale të detyrime të prapambetura, Ligji Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” në nenin 7 “Kategoritë që bëhen publike pa kërkesë” ka përcaktuar se:

Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit.....

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifatat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara.

Për sa më sipër, ju bëjmë me dije se Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dalë me Udhëzimin Nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, i cili në kreun II të tij ka përcaktuar se të dhënat e kërkuara në rastin konkret bëhen publike pranë faqes zyrtare të MFE.

Referuar ligjit të sipërcituar Nr.119/2014 neni 7 “Kategoritë që bëhen publike pa kërkesë” të dhënat e kërkuara nga ju, mund të aksesohen pa kërkesë pranë faqes zyrtare të MFE.

Faleminderit për mirëkuptimin.